

Fjalorth

Ritmi absolut

Aftësia për të kënduar një ritëm të dhënë (dmth, frekuencën e notës) pa referim të jashtëm.

Aminoacid

Një pjesë përbërëse e proteinave. Ka afro njëzet aminoacide të ndryshme që përdoren për të formuar proteinat.

Arkipelag

Një grup ishujsh

Bioturbim

Përzierja e sedimenteve me anë të veprimtarisë organike, të tillë si me anë të rrënjëve të bimëve, krimbave dhe veprimtarive të butakëve për bërjen e strofkullave.

Bipedal

I aftë për të qëndruar mbi dy këmbët dhe për të ecur mjaft mirë me dy këmbë.

Klasë

Një grup klasifikimi poshtë tipit dhe që përmban një osë më shumë rende. Psh. Mammalian (gjararët).

ADN

Acidi Dezoksiribonukleik. Një acid nukleik që mbart informacionin gjenetik.

Familje

Një grup klasifikimi nën rendin dhe që përmban një ose më shumë gjini. Psh. Canidae (Familja e qenve), që përfshin ujqit, dhelprat, kojotat dhe çakejtë.

Fauna

Jeta shtazore.

Flora

Jeta bimore.

Gjenet

Një segment i ADN-së që kalon nga një brez në tjetrin dhe i cili përmban informacion që përdoret për të specifikuar formën ose funksionin e organizmit.

Koha e riprodhimit

Intervali mes lindjes së një individi dhe lindjes së pasardhësit të tij.

Gjenetika

Studimi i karakteristikave të trashëguara të transmetimit dhe të llojshmërisë.

Gjenomi

I gjithë informacioni gjenetik i një organizmi, siç është koduar tek ADNja.

Gjinia

Grup klasifikimi nën familjen dhe që përmban një ose më shumë specie. Psh. Equus (që përfshin kuajt, gomerët dhe zebrat).

Kolona gjeologjike

Një seksion vertikal përmes shkëmbinjve sedimentarë të tokës, me shkëmbinjte e depozituar më vonë (dhe për këtë arsye më të rinj në moshë) në krye të saj dhe me shkëmbinjte më të vjetër, më të hershëm, të depozituar në fund të kolonës.

Gjeologjia

Studimi i historisë së tokës, sidomos siç regjistrohet te shkëmbinjte.

Gjysmë jeta

Koha që i duhet një materiali radioaktiv për ta humbur gjysmën e radioaktivitetit të tij.

Vdekja e Nxehtësisë

Gjendja përfundimtare teorike e gjithësisë, kur ajo ka shkuar në një gjendje pa aspak fare energji të lirë termodinamike për të qenë në lëvizje ose për të mbajtur jetën.

Homologjia

Ngjashmëria në pozicion dhe formë i një organi ose strukture të caktuar që

Fjalorth

shihet në organizmat e tjera, që besohet nga evolucionistët se është për shkak të të qenët të prejardhur nga një paraardhës evolucionar i përbashkët.

Shkëmbinjtë vullkanikë

Shkëmbinjtë që formohen nga ngurtësimi i llavës (ose i magmës).

I pajetë

Jo i gjallë.

Jo vertebror

Një kafshë pa shtyllën kurrizore.

Makro-evolucion

Ndryshime në shkallë të madhe në organizmat që rezultojnë në grupe të reja klasifikimi, të tilla si familjet, rendet, klasat etj.

Makro-molekulë

Një molekulë shumë e madhe, e tillë si një polimer ose proteinë, që përbëhet nga shumë njësi të vogla të lidhura së bashku.

Gjitar

Një klasë e kafshëve vertebrorë me gjak të ngrohtë që karakterizohet nga një mbulesë me qime në lëkurë dhe, te femra, me gjendra për prodhimin e qumështit për t'i ushqyer të vegjlit.

Marsupialët

Një gjitar, femra e të cilit e mbart dhe i jep gji të voglit të saj në një qese në pjesën ballore të trupit të saj, deri sa ai arrin në një gjendje pjekurie.

Mikro-evolucion

Evolucioni që rezulton nga një seri e variacioneve të vogla gjenetike që shpesh shkaktojnë formimin e nënspecieve të reja.

Morfologjia

Studimi i formës dhe strukturës së organizmave pa marrë në konsideratë funksionin.

Mutacioni

Një ndryshim në strukturën gjenetike të një organizmi.

Ontogjenia

Zhvillimi i një organizmi nga stadi i tij më i hershëm deri në pjekuri.

Rendi

Një grup klasifikimi nën tipin dhe që përmban një ose më shumë familje, psh. Carnivora (mishngrënësit)

Paleontologjia

Studimi i historisë së jetës siç regjistrohet te fosilet.

Petrifikimi [Ngurtësimi]

Ndryshimi i lëndës (organike) në gur.

Filogjenia

Historia e zhvillimit evolucionar të një organizmi.

Faza filotipike

Një fazë në zhvillimin embrional në të cilën disa specie(vertebrorë) i ngjajnë shumë njëra-tjetrës. Evolucionistët besojnë se kjo ndodh për shkak të marrëdhënies së tyre filogjenetike.

Tipi

Një grup klasifikimi nën mbretërinë dhe që përmban një ose më shumë klasa, psh. kordatët.

Plaçentalët

Një gjitar të vegjlit e të cilit e përfundojnë zhvillimin e tyre embrional në mitër, të bashkuar me nënën me anë të një plaçente.

Polistrat

Që kalon nëpër më shumë se një shtresë shkëmbi.

Fjalorth

Gjenetikat e popullatave

Studimi i trashëgimisë dhe përhapjes së gjeneve në popullatat.

Primatët

Një rend gjitarësh që përfshin lemurët, tarsierët, majmunët dhe njerëzit.

Primordiale [I lashtë, fillestare]

Që ekzistonte përpara se të fillonte jeta.

Proteina

Një komponim organik që përbëhet nga një zinxhir aminoacidesh që kanë role strukturore ose funksionale në organizmat. Shembujt janë hemoglobina (e cila e transporton oksigjenin në rrjedhën e gjakut) dhe keratina (përbërësi kryesor i thonjve, flokëve, puplave, thundrave, etj). Struktura ose funksioni i proteinës varet nga tipi i amino-acidit në secilin pozicion të zinxhirit. Vetëm një pjesë e vogël e kombinimeve të aminoacideve do të shkaktojnë formimin e një proteine të dobishme nga pikëpamja biologjike.

Datimi Radiometrik

Një metodë që përdoret për të përcaktuar moshën e një shkëmbi ose një minerali duke matur përpjesëtimet e një materiali origjinal radioaktiv dhe produktit të zbërthimit të tij.

Brejtësit

Një gjitar i tillë si një mi, ose një ketër, që ka dhëmbë të përshtatur për të brejtur.

Shkëmb sedimentar

Shkëmb i formuar nga sedimentet e depozituara ose nga uji, ose nga era.

Vetë-përsëritja

Një proces me anë të të cilit diçka bën një kopje të vetes.

Sonar

Një metodë e pozicionimit me tinguj, që përdoret nga kafshë të tilla si lakuriqët e natës dhe balenat.

Specifizimi

Procesi me anë të të cilit dalin speciet e reja.

Speciet

Grupi i klasifikimit nën gjininë. Psh. Felis Catus (macja shtëpiake).

Stratigrafia

Dega e gjeologjisë që ka të bëjë me rendin dhe datimin relativ të shtresave të shkëmbinjve.

Klasifikimi

Klasifikimi i organizmave sipas strukturave të tyre. Për shembull, njerëzit klasifikohen si më poshtë: Mbretëria: Animalia [e kafshëve]; Tipi: Kordatët; Klasa: Gjitarët; Rendi: Primatët; Familja: Hominidae; Gjinia: Homo; Lloji / specia: Homo sapiens.

Tokësor

Që jeton mbi dhë ose në të.

Transoqeanik

Që kapërcen një oqean.

Vertebror

Një kafshë që ka shtyllë kurrizore ose kolonë shpinore.

Zirkoni

Silikati i Zirkonit.